



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

Instituti për Planifikim Hapësinor/Institut za Prostorno Planiranje/Institute for Spatial planning

**LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP**

<b>REFERENCË:</b>			
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Z. Arben Çitaku, UD Sekretar Permanent në MMPH		
<b>CC:</b>			
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	Luan Nushi, drejtor në IPH		
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Rizah Murseli, Hulumtues Profesional (Planer) në IPH		
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Raport për pjesëmarrje në Shkollën Verore Evropiane për Planifikim Urban 2010 (EUSS 2010) të mbajtur në Wrocław të Polonisë.		
<b>Nr. i zyrës:</b>	<b>Lokacioni:</b>	<b>Data:</b>	<b>23.09.10</b>
<b>Br. kancelarije:</b>	<b>Kucni:</b>	<b>Datum:</b>	
<b>Room No.:</b>	<b>Extension:</b>	<b>Date:</b>	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION			<input type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL			<input type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE			<input type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION			<input type="checkbox"/>
<b>AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE</b>			

Të nderuar,

Të bashkëngjitur e keni raportin e shkurtër lidhur me pjesëmarrjen në “Shkollën Verore Evropiane për Planifikim Urban 2010 (EUSS 2010)”

# Raport

---

Organizator	UN-Habitat, AESOP and Wroclaw University of Technology.
Pjesëmarrës	Kryesisht planer të rinjë nga shtetet e Evropës si dhe ligjerues nga universitete të ndryshme evropiane. Pjesëmarrja ime ishte në kuadër të MMPH-së.
Vendi	Wroclaw University of Technology, Wroclaw Poloni.
Data	10 - 19.09.2010

---

Shkolla Verore Evropiane për Planifikim Urban tuboi planerët e rinjë kryesisht nga evropa por edhe me gjerë për të punuar së bashku në qështjet e ndryshme urbane dhe për të shkëmbyer eksperiencat kryesisht në nivel Evropian. Ligjeruesit kanë qenë nga universitete të ndryshme evropiane si dhe kompani të ndryshme private të cilat mirren me planifikim urban. Kjo shkollë ishte një rast shumë i mirë për mësuar sfidat e kohës që preokupojnë qytetet e ndryshme në mbar Evropën.

Shkolla Verore Evropiane për Planifikim Urban duke ditur se e "vjetra", e "kaluara" dhe "trashgëmia" janë në trend për qështjet e planifikimit në evropë është munduar të ju përgjigjet pyetjes, nëse këto janë edhe të qëndrueshme? Për të dhënë përgjigjet në pyetjet e mësipërme janë mbajtur një mori ligjerata, workshope dhe vizita në terren të përcjellura me detyra konkrete të cilat ishin të fokusuara në lagje të ndryshme të qytetit të Wroclawës.

Organizimi i shkollës verore evropiane për planifikim urban ka qenë;

- Ligjerata mbi konceptet të ndryshme të planifikimit në Evropë,
- Formimin e grupeve punuese nga pjesëmarrësit, të cilat më vonë kanë punuar në raste të ndryshme studimi për qytetin Wroclaw,
- Studime në terren duke përfshirë edhe intervista me banorë të lagjeve në studim,
- Përgaditja e prezenteve për debat për secilin nga 6 grupet punuese,
- Diskutime për secilin rast të dhënë nga të 6 grupet punuese,
- Përgaditja e raportit final (secili grup ka përgaditur nga 3 raporte gjatë 10 ditëve) për publikim në një nga publikimet shkencore të Universitetit Teknologjik të Wroclawës.

Ndërsa ligjeratat kanë qenë të temave si më poshtë:


- Nga Përspektiva Gglobale ... raporti i UN-Habitatit për Gjendjen e Qyteteve në Botë,
- Veglat Urbane dhe Regjenerimi Urban në EU,
- Çka është vërtet e rëndësishme në trashëgimi?,
- Çka është esenciale rreth trashëgimisë? Koncepte teorike,
- Si ti përmirsojmë zonat me trashëgimi? Përtej planeve; Rasti studimorë në Madrid,
- Identiteti dhe Autenticiteti në rigjenerimin urban,

- A është vërtetë historia dhe trashgëmia e rëndësishme në planifikim urban,
- Mekanizmat për përkrahjen e investimeve dhe përfitjen për regjenerimin urban dhe kualitetin e Ri urban,
- Rritja dhe dinamika urbane. Rast studimi nga Athina,
- Format e reja urbane në praktikë. Rast studimi nga Kamëza,
- Forma të reja të qytetit: Format e qytetit, Shtresat e intervenimit; Veqorit, Qeverisja, Kapaciteti, Metodologjit Analizuese për qytete,
- Diagonalja e Evropës Jugore; Strategjit hapësinore si ndërlojtare në mes të mega-regjioneve dhe lokaliteteve,
- Hibridizimi Urban,
- Zonat kufitare; sfida për periferitë,
- Ëndërrat dhe realiteti - Rasti studimor nga Wroclawa,
- A mund të mësohet prej të ardhmës? Simulimet e Rritjes Urbane. Rasti studimor nga Wroclawa,
- Morfologjia Urbane – duke inkorporuar kompleksitetin dhe variabilitetin,
- Dizajnimi i qëndrueshëm urban – shembujt dhe perspektivat. Çka mund të mësojmë nga Evropa Veriore?,
- Shpirtarat kryesorë të qytetit. Rasti studimor nga Torina,
- Dizajnimi Urban dhe Ndryshimet klimatike- Një nevojë publike?, etj.

Të gjitha preznetimet nga EUSS 2010 do të publikohen së shpejti në web sajtin zyrtar të Shkollës Verore Evropiane për Planifikim Urban 2010.

<http://www.unhabitat.org.pl/euss/>

Disa punime të grupit punues 5, pjesë e secilit kam qenë unë dhe disa fotografi pune:





Në fund të programit të gjithë pjesmarrësit kanë marrë nga një certifikat pjesmarrëse në këtë shkollë verore profesionale.

Rizah Murseli, Hulumtues Profesionale (Planer),  
IPH - MMPH